



Si ta mbroni beben nga RSV-ja

Sa e zakonshme është RSV-ja?

- **1 në 2 bebe** infektohen me RSV-ja çdo dimër. Shumë prej tyre kanë nevojë për kujdesin mjekësor të një doktori ose të pavijonit të urgjencës.
- **3 në 100 bebe** çohen në spital dhe disa kanë nevojë për kujdes intensiv.

Vaksinimi me “nirsevimab”

- Ne rekomandojmë t'i bëni vaksinën “nirsevimab” bebes suaj për ta mbrojtur nga infektimi i rëndë me RSV.
- Vepron menjëherë për ta mbrojtur beben për rreth 5 muaj gjatë vjeshtës dhe dimrit, kur RSV-ja është në nivelet më të larta.
- Mund të bëhet krahas vaksinave të tjera për fëmijët.
- Vepron në mënyrë të tillë që t'i japë drejtpërdrejt trupit të bebes suaj antitrupe që i duhen për të luftuar infeksionin.

Si mund ta vaksinoni beben kundër RSV-së?

- Bebet që lindin midis datave **1 shtator 2026 dhe 28 shkurt 2027**: Ne ofrojmë vaksinim për beben tuaj përpara se të largoheni nga materniteti.
- Bebet që kanë lindur ose lindin midis datave **1 mars 2026 dhe 31 gusht 2026**: Mund t'i bëni vaksinën te mjeku i familjes.
- **Bebet me rrezik të lartë**, nën 24 muajshe: Flisni me pediatrën ose neonatologun.

Siguria dhe efektet anësore

- Studimet kanë treguar se “nirsevimab”-i është i sigurt dhe efektiv.
- Shumica e bebeve nuk shfaqin efekte anësore. Më pak se 1 në 100 mund të kenë skuqe me puçrra, skuqe të thjeshtë të lëkurës ose temperaturë.
- Reaksionet alergjike ose hiperndjeshmëria ndodhin rrallë.
- Bebet monitorohen nga afër për 15 minuta pas injektimit.

Çfarë është virusi sincicial i frymëmarrjes (RSV)?

RSV-ja është virus i zakonshëm që mund të shkaktojë infeksione respiratore (frymëmarrjeje) te bebet e vogla. Bebet nën gjashtë muajshe sëmuren më rëndë nga RSV-ja sesa bebet më të rritura.

Vaksinimi kundër RSV-së është falas. Ai e mbron beben nga infektimi i rëndë me RSV, duke pakësuar kështu rrezikun për shtrim në spital me mbi 80%.



Për më shumë informacion

Nëse keni pyetje, flisni me maminë, infermierën e familjes, infermierën e shëndetit publik, mjekun e familjes ose pediatrën.

- hse.ie/RSV
- Agjencia Evropiane e Mjekimeve (European Medicines Agency): ema.europa.eu

